

POLITIKAT STABILIZUESE NË
SHQIPËRI DHE EFIKASITETI I TYRE

Volker Treichel

Përfaqësuesi i përhershëm i FMN-së në Shqipëri

POLITIKAT DHE ZHVILLIMET MAKROEKONOMIKE

Mjedisi i përgjithshëm

1. Gjatë periudhës 1993 - 1995 zhvillimet makroekonomike në Shqipëri u karakterizuan nga norma të larta rritjeje, inflacioni zbriti në vlera njëshifrore ndërsa çbalancimet e jashtme u reduktuan ndjeshëm⁹. Kjo ecuri pozitive makroekonomike ishte rrjedhojë, në një masë të madhe, e eliminimit tërësor të kontrolleve, e privatizimit të shpejtë të sektorit bujqësor, e tregtisë me pakicë dhe ndërmarrjeve të mesme dhe të vogla, e përmirësimit të disiplinës financiare në nivelin buxhetor dhe në atë të ndërmarrjeve shtetërore.

2. **Megjithatë, në vitin 1996, politikat makroekonomike patën një përkeqësim të ndjeshëm, deficitin buxhetor i financiar u burime të brendshme u rrit me 4 pikë përqindjeje, duke arritur pothuaj 11 për qind të PBB-së dhe inflacioni u trefishua duke arritur në 17 për qind.** Një faktor kyç që ndikoi në këtë përkeqësim ishte reduktimi dramatik i të ardhurave buxhetore - kryesisht si pasojë e kolapsit, pothuaj total, të të ardhurave nga akcizat, të cilat më parë ishin rritur nga anashkalimi masiv i embargos tregtare të vendosur nga OKB kundrejt Republikës Federative të Jugosllavisë, e cila u eliminua në fund të vitit 1995. Për më tepër, politika e shpenzimeve buxhetore u zbut ndjeshëm përpara zgjedhjeve të përgjithshme parlamentare të majit të vitit 1996.

3. **Në fillim të vitit 1997, rënia e firmave piramidale e zhyti Shqipërinë në një krizë të rëndë ekonomike dhe shoqërore.** Konflikti i nxitur nga kolapsi i skemave piramidale precipitoi deri në kufijtë e një lufte civile, në një kohë që qeveria humbi kontrollin mbi një pjesë të madhe të vendit¹⁰. Institucionet shtetërore pushuan së funksionuari,

⁹ Cilësia e të dhënave në dispozicion e bën të vështirë vlerësimin me saktësi të zhvillimeve makroekonomike në Shqipëri. Megjithatë, rritja e fortë ekonomike e Shqipërisë në vitet e para të tranzicionit dëshmohej nga disa tregues të përafërt, veçanërisht në sektorin e bujqësisë dhe në atë të shërbimeve. Një përshkrim më të zgjeruar të periudhës para vitit 1997 mund ta gjeni në "Albania - Recent Economic Developments". IMF, April 1997.

¹⁰ Skemat piramidale ishin kompani, të cilat duke pretenduar se merreshin me investime fitimprurëse tërhoqën një vëllim gjithnjë e më të madh fondesh nga depozituesit privatë me premtimin e normave të jashtëzakonshme të kthimit. Në realitet, fondet e depozituesve nuk u përdorën për investime serioze, por për të paguar interesin e depozitave ekzistuese, ose u transferuan nga pronarët e këtyre firmave në llogaritë e tyre bankare personale jashtë Shqipërisë. Skemat piramidale u rrëzuan në fillim të vitit 1997 duke shkaktuar, sipas disa vlerësimeve, një humbje kursimesh për depozituesit në masën 1 miliard usd. Kriza e skemave piramidale është përshkruar në një studim të FMN (IMF Working Paper) nga Chris Jarvis (1999).

ndërsa aktiviteti ekonomik u paralizua. Trazirat reduktuan ofertën, veçanërisht në sektorët e industrisë dhe të ndërtimit, ndërsa humbja e kursimeve në skemat e dështuara piramidale zvogëloi kërkesën. Si pasojë e uljes së ndjeshme të dërgesave të emigrantëve, mosekzistencës virtuale të ndihmës së huaj dhe ngadalësimit të shkëmbimeve tregtare me vendet partnere, nënçmimi i lekut, gjatë gjysmës së parë të vitit 1997, tejkaloi 40 përqindshin. Në fund të vitit 1997 inflacioni vjetor kërceu në 42 për qind, duke reflektuar nënçmimin masiv të lekut, fenomenet *shock* që sollën reduktimin e ofertës, dhe rritjen e shpejtë të deficitit fiskal që erdhi si rrjedhojë e zvogëlimit të ndjeshëm të të ardhurave tatimore. Deficiti u financua kryesisht nëpërmjet huamarrjes së brendshme, duke bërë që borxhi publik të kapte nivele të papara dhe duke e ngarkuar buxhetin e viteve të ardhshme me shpenzime të larta për pagimin e interesave.

- 4. Përpjekjet e qeverisë për ta vendosur Shqipërinë në një rrugë të qëndrueshme përmirësimi dhe reformash - edhe me mbështetjen e Fondit Monetar Ndërkombëtar - kishin si synim stabilitetin makroekonomik, rindërtimin dhe forcimin e aftësive institucionale dhe administrative dhe rifillimin e reformave strukturore.** Më poshtë, dëshiroj të ndalem në elementet kryesore të programit qeveritar të stabilizimit makroekonomik dhe efektet e tyre në rritjen ekonomike, në inflacion dhe në bilancin e pagesave.

ASPEKTET KRYESORE TË PËRMIRËSIMIT MAKROEKONOMIK QË NGA VITI 1997

5. Që nga viti 1997, Banka e Shqipërisë ndërmoi një politikë të shtrënguar monetare, e evidentuar kjo nga normat e larta të interesit real (të paraqitura në tabelën 1) të cilat stabilizuan kursin e këmbimit duke krijuar një kërkesë të lartë për aktivet financiare në lekë dhe duke ndihmuar trendin rënës të shpejtësisë së parasë, konsistent me nivelet më të ulta të inflacionit. Një instrument kyç në sigurimin e normave pozitive të kthimit ishte vendosja nga Banka e Shqipërisë e normave minimale të interesit për depozitat¹¹. Më tej, kreditimi i sektorit joqeveritar u kufizua

¹¹ Normat e detyrueshme minimum të depozitave janë vendosur për herë të parë në vitin 1992.

ndjeshëm nga kufizimet preventive të kreditimit të zbatuara mbi bankat me kapital shtetëror, të cilat kishin një shkallë të lartë kredish me probleme në portofolin e tyre.

Tabelë 1. Normat e interesit, 1996 - 2001 (përqindje vjetore).

	1996	1997	1998	1999	2000	2001
Depozita 12-mujore	19.1	27.8	16.5	9.1	7.7	7.7
Noma reale e depozitave	1.7	-14.3	7.8	10.1	3.5	4.2
<i>Yield-i mesatar i ponderuar i bonove të thesarit</i>						
3-mujore	14.5	32.4	27.4	14.5	10.7	7.7
6-mujore	18.4	31.2	28.4	18.6	13.0	9.8
12-mujore	18.8	32.8	29.3	19.5	14.0	10.5
<i>Yield-i real i b.th. 12-m</i>	1.4	-9.3	20.6	20.5	9.8	7.0

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Vetëm në fillim të vitit 2000, Banka e Shqipërisë ndërmori një lehtësim gradual të politikës monetare, në përgjigje të normave të ulta të inflacionit dhe presioneve mbiçmuese ndaj kursit të këmbimit¹². Normat e interesit të bonove të thesarit tremujore pësuan një rënie të shpejtë, nga 14.9 për qind në janar të vitit 2000, në 7.7 për qind në tetor të vitit 2001, kryesisht duke reaguar ndaj sinjaleve të Bankës së Shqipërisë lidhur me normat e interesit, uljes së huamarrjes nga ana e qeverisë, si dhe efektit të një pjesëmarrjeje më të madhe të bankave private dhe të investitorëve jobankarë në ankandet e bonove të thesarit. Gjithashtu, normat e interesit të depozitave dhe të kredive ranë ndjeshëm duke filluar të ushtrojnë një impakt pozitiv në aktivitetin e kreditimit të sektorit privat.

Politika fiskale pas vitit 1997, arriti një balancë midis nevojës për të përmbajtur deficitin fiskal dhe nevojës për të financuar shpenzimet publike esenciale. Procesi i konsolidimit fiskal duket qartë në zvogëlimin e deficitit të përgjithshëm¹³ dhe veçanërisht në rënien e ndjeshme të financimit të tij nga burimet e brendshme. Ky i fundit zbriti nga 10.8 për qind e PBB-së në vitin 1996, në rreth 3 për qind në vitet 2000 dhe 2001. Reduktimi i deficitit u bë i mundur kryesisht nga përpjekjet për rritjen e të ardhurave

¹² Për sa kohë që presionet inflacioniste u zbehën që në vitin 1999, një lehtësim i politikës monetare mund të kishte qenë i arsyeshëm që atë vit.

¹³ Deficiti i përgjithshëm përfshin edhe shpenzimet e financuara nga grantet dhe huatë e kushtëzuara.

buxhetore, nga vendimi i qeverisë për të ndërprerë mbështetjen financiare në formën e subvencioneve dhe huave me kushte lehtësuese për ndërmarrjet në pronësi shtetërore (me përjashtim të disa kompanive, si për shembull, kompanisë së prodhimit dhe shitjes së energjisë KESH) dhe nga ndërmarrja e një politike privatizimi të shpejtë dhe në shkallë të gjerë. Megjithatë, deficitit i përgjithshëm mbeti i lartë, në përgjigje të nevojave të rindërtimit të infrastrukturës të shërbimeve bazë publike dhe të rivendosjes së rendit dhe sigurisë në vend. Nivelet e larta të deficitit, sidoqoftë nuk u shoqëruan me inflacion të lartë sepse ato u financuan kryesisht nga një miksi i huave koncensionale të huaja dhe nga huamarrja e brendshme me norma të larta reale interesi.

Tabelë 2. Përmasat e deficitit, 1996-2001
(në përqindje ndaj PBB-së).

	1996	1997	1998	1999	2000	2001 ¹⁴
Deficiti total	12.8	12.9	10.4	11.4	9.1	9.5
Deficiti i brendshëm	11.0	11.0	6.4	5.4	4.9	5.5
- përjashtuar të ardhurat e privatizimit	10.8	10.7	6.4	5.2	3.2	3.3
Deficiti primar	8.9	7.3	2.6	4.4	3.4	5.0
Përjashtuar projektet me financim të huaj	7.7	5.1	-0.3	1.1	0.4	1.1

Burimi: Ministria e Financave.

- Politikat e kujdesshme monetare dhe fiskale patën një ndikim pozitiv në nivelin e remitancave të shqiptarëve, që punojnë jashtë si dhe në sasinë e ndihmave të donatorëve, duke ndihmuar kështu në stabilizimin e kursit të këmbimit të lekut. Secili nga këta faktorë kontribuoi në krijimin e një klime të rritjes së lartë dhe të inflacionit të ulët. Remitancat e larta ndihmuan rritjen e shpejtë (tabela 3). **Pas përmirësimit të rendit publik, remitancat u kthyen shpejt në nivelet e shënuara para krizës, duke ndihmuar në rritjen ekonomike - veçanërisht në sektorët e ndërtimit dhe të shërbimeve - dhe duke luajtur një rol vendimtar në kompensimin e mungesës së huadhënies bankare ndaj sektorit privat.**

Tabelë 3. Remitancat nga shqiptarët që punojnë jashtë
(në milionë usd).

¹⁴ Parashikime.

	1996	1997	1998	1999	2000	2001 ¹⁵
Remitancat	499.6	266.9	452.2	368.1	530.8	568.0

Burimi: Banka e Shqipërisë dhe vlerësime të FMN.

- Mbështetja e donatorëve, e cila që nga viti 1997 ka arritur mesatarisht në 5 për qind të PBB-së, luajti një rol të rëndësishëm në uljen e huamarrjes së brendshme dhe në krijimin e infrastrukturës të nevojshme për të ndihmuar rritjen ekonomike.
- Këto flukse të larta të kapitalit të huaj si dhe fenomeni i zëvendësimit të monedhave, i ndikuar nga norma të brendshme reale interesi të larta, rezultuan në një mbiçmim të lekut **kundrejt dm duke përbërë një faktor kritik në reduktimin e inflacionit, në qoftë se do të kemi parasysh edhe faktin se një peshë e madhe e indeksit të çmimeve të konsumit përbëhet nga mallrat e importuar¹⁶ (tabela 4).**

Tabelë 4. Kurset e këmbimit, 1996 - 2000 (mesatare e periudhës).

	1996	1997	1998	1999	2000
Lek/USD	104.5	148.9	150.6	137.7	143.7
Lek/DM	69.5	85.7	85.7	75.1	67.8

Burimi: Banka e Shqipërisë.

INFLACIONI, RITJA DHE BILANCI I PAGESAVE QË NGA VITI 1997

- 9. Rritja ekonomike e Shqipërisë, që nga viti 1997, ka qenë e fortë, duke qëndruar mesatarisht në nivelin 7 për qind në terma realë (tabela 5).** Menjëherë pas kolapsit të skemave piramidale dhe krizës ekonomike dhe sociale që pasoi, rritja ekonomike ka ardhur si pasojë e rikthimit në nivele normale të aktivitetit në sektorin bujqësor dhe, gjithashtu, edhe nga ringritja e shpejtë e aktivitetit në sektorin e ndërtimeve, atë të transportit dhe të shërbimeve. Në vitin 1998, prodhimi i brendshëm bruto u rrit me 8 për qind, duke kompensuar plotësisht rënien e tij në vitin 1997. Në vitin 1999, konflikti në Kosovë dhe kriza e refugjatëve e zbehu disi aktivitetin bujqësor, por prania e një numri të madh refugjatësh - shumë prej të cilëve mbështeteshin në kursimet e tyre - dhe e organizatave ndërkombëtare të

¹⁵ Parashikime.

¹⁶ Shikoni gjithashtu Hadëri (1996).

ndihmave soli një *shock* pozitiv mbi kërkesën, duke ndihmuar vazhdimin e rritjes së shpejtë në sektorët e transporteve dhe të shërbimit. Gjatë dy viteve të fundit, 2000 dhe 2001, aktiviteti bujqësor dhe, gjithashtu, edhe ritmet e rritjes në sektorët e transportit, të shërbimeve dhe të ndërtimit pësuan rritje, por rritja e regjistruar zyrtarisht në sektorin industrial u ngadalësua për shkak të pakësimit të aktivitetit në ndërmarrjet industriale shtetërore. Gjithashtu, gjatë viteve 2000-2001, përkeqësimi i krizës energjitike filloi të ulë rritjen e sektorit privat, industrial dhe të shërbimeve.

Tabelë 5. Rritja reale sipas sektorëve, 1996 – 2001 (në përqindje).

	1996	1997	1998	1999	2000	2001	Raporti ndaj PBB në 2001
Total	9.1	-7.0	8.0	7.3	7.8	7.3	100.0
Industri	13.6	-5.6	4.1	6.4	5.0	5.0	11.5
Bujqësi	3.0	1.0	5.0	3.7	6.0	4.0	51.0
Ndërtim	18.4	-6.3	21.0	15.0	18.0	17.0	14.8
Transport	-0.9	-20.5	20.0	15.0	15.0	12.0	3.5
Shërbime	20.1	-25	10.0	12.0	10.0	9.0	19.2

Burimi: INSTAT.

10. Duhet pranuar se vlerësimet e rritjes ekonomike nuk janë shumë të besueshme, për sa kohë që nuk ekzistojnë ende llogaritë kombëtare, dhe vlerësimet zyrtare të rritjes mbulojnë, jo në mënyrë të plotë, aktivitetin e sektorit privat dhe të sektorit joformal. Megjithatë, të dhëna të ndryshme tregojnë se diversifikimi më i madh i rritjes që ka ndodhur pas vitit 1998, si rezultat i rigjallërimit të sektorit industrial dhe - më së fundi - rritja e aktivitetit bujqësor, nuk është përfshirë si duhet në shifrat zyrtare, megjithëse ajo reflektohet në disa tregues të përafërt, si niveli i lartë i importit të makinerive dhe pajisjeve, rritja e eksporteve dhe sjellja e parasë në qarkullim (tabela 6).

Tabelë 6. Importi i makinerive dhe pajisjeve, para ja në qarkullim dhe rritja e eksporteve, 1996 - 2001 (1996=100).

	1996	1997	1998	1999	2000	2001 ¹
--	------	------	------	------	------	-------------------

Importi i makinerive dhe pajisjeve	100	61	66	86	113	145
Paraja në qarkullim	100	147	138	165	202	226
Rritja e eksporteve	100	73	90	120	113	116

¹ Janar-shtator 2001 krahasuar me janar-shtator 2000.

Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

11. Rritja ekonomike e Shqipërisë në vitet e fundit ka patur një impakt pozitiv edhe në normën e papunësisë, e cila ra nga 18 për qind në vitin 1998, në rreth 15 për qind në qershor të vitit 2001. Megjithëse të dhënat zyrtare e nënçmojnë shkallën e papunësisë për shkak të regjistrimit jo të plotë, ato sigurojnë të dhëna për prirjet bazë. Megjithë reduktimin e papunësisë, inflacioni ka qenë në rënie, pothuaj të vazhdueshme, gjatë periudhës 1997 - 2001, nga një normë vjetore rritjeje prej 42 për qind në vitin 1997, në 1.8 në tetor të vitit 2001 (tabela 7). Megjithëse indeksi i çmimeve të konsumit bazohet në pesha të përcaktuara në vitin 1993 dhe nuk reflekton më tiparet aktuale të konsumit, një indeks i ri i çmimeve të konsumit, i ndërtuar së fundmi, duke u bazuar në anketën e shpenzimeve konsumatore të vitit 2000, rezultoi në norma më të ulta inflacioni, për shkak se pesha e çmimeve ushqimore - e cila sillte një shkallë luhatshmërie në indeksin e çmimeve të konsumit - u reduktua në favor të veshjeve, të strehimit dhe, veçanërisht, të shërbimeve. Përgjithësisht, Shqipëria që nga viti 1998 ka patur një stabilitet relativ çmimesh.

Tabelë 7. Inflacioni vjetor, 1996 - 2001 (në përqindje).

	1996	1997	1998	1999	2000	2001 ¹
Inflacioni vjetor (mesatare vjetore)	12.7	32.1	20.9	0.4	0.0	...
Inflacioni vjetor (në fund të vitit)	17.4	42.1	8.7	-1.0	4.2	1.8

¹ Tetor.

Burimi: INSTAT.

Si mund të shpjegohet saktësisht përvoja e Shqipërisë me rritje të lartë dhe inflacion të ulët, përderisa strategjitë antiinflacioniste nuk janë në pajtim me rritje të lartë ekonomike? Ndërsa politikat stabilizuese mund të jenë vendimtare në rikthimin e besimit dhe, për këtë arsye, në ruajtjen e kapacitetit prodhues, efekti i tyre afatshkurtër mbi kërkesën tenton të jetë negativ. Prodhimi i ndërmarrjeve shtetërore në realitet, pësoi një ulje graduale gjatë

viteve 1997-2001, në një kohë që mundësia e tyre për huamarrje nga sistemi bankar u ul dhe subvencionet nga buxheti i shtetit u eliminuan gradualisht. Në mënyrë të ngjashme, ulja e numrit të punonjësve publikë, nga niveli 150.000 në vitin 1997 në rreth 120.000 aktualisht, krijoi presione në tregun e punës. Megjithatë, këto efekte negative u kompensuan nga dinamizmi i sektorit privat, i cili u financua kryesisht nga remitancat dhe në të cilin rrogat janë fleksibile.

- 12. Rritja e fortë ekonomike e Shqipërisë dhe ulja e inflacionit u shoqëruan me një forcim relativ të bilancit të pagesave, nën ndikimin e volumeve më të mëdha të eksporteve, të remitancave dhe të investimeve të huaja direkte.** Megjithëse, si pasojë e aftësive prodhuese të brendshme të vogla, deficiti i llogarisë korente të Shqipërisë ka qenë i madh që në fillimet e periudhës së tranzicionit, që nga viti 1996 pesha e tij ndaj PBB-së është zvogëluar me dy pikë përqindjeje, si pasojë e rritjes së eksporteve dhe remitancave më të larta. Ky zhvillim është i rëndësishëm, në një kohë që rritja e regjistruar në importe, gjatë viteve të fundit, reflekton në njëfarë mase forcimin e kontrollit kufitar dhe pakësimin e kontrabandës, kështu që përmirësimi real i llogarisë korente mund të jetë edhe më i madh se ai i regjistruar në të dhënat statistikore.
13. Që nga viti 1996, eksportet janë rritur disi, nën ndikimin e rritjes së eksporteve të mallrave të ripërpunuar (tekstile dhe këpucë) dhe - së fundi - mineraleve, por, në nivelin 7.5 për qind të PBB-së, eksportet shqiptare mbeten shumë të ulta duke u krahasuar me ekonomitë e tjera në tranzicion ose në zhvillim.

**Tabelë 8. Eksporti sipas grupmallrave, 1996 - 2001
(në milionë usd).**

	1996	1997	1998	1999	2000	2001 ¹
Total	229.2	167.2	204.8	274.0	259.0	306.0
Ushqim, pije, duhan	20.4	21.0	19.9	18.4	17.1	...

dhe kafshë të gjalla						
Materiale të papërpunuara, pa karburante	38.7	31.2	33.8	20.0	22.5	...
Karburante, lubrifikante dhe minerale	9.4	6.2	2.5	7.7	4.9	...
Vajra dhe yndyrna shtazore dhe bimore	5.0	0.0	0.4	0.3	0.0	...
Produkte kimike	3.2	2.3	1.6	1.9	1.8	...
Produkte të përpunuara	31.6	16.9	25.2	32.9	31.3	...
Makineri dhe pajisje transporti	3.9	6.8	5.7	17.3	5.2	...
Artikuj të ndryshëm të përpunuar	117.0	82.7	115.6	175.6	176.1	...

¹ Tetor.

Burimi: Banka e Shqipërisë.

14. Rritja e vazhdueshme e remitancave që nga viti 1997 (shih tabelën 3), e ndërprerë përkohësisht nga kriza e Kosovës, ka qenë një faktor vendimtar në forcimin e bilancit të pagesave. Pozicioni gjeografik i Shqipërisë, si fqinje e dy vendeve anëtare të BE (Greqisë dhe Italisë), dhe diferencat e mëdha në pagë midis Shqipërisë dhe tyre, favorizon emigracionin në shkallë të gjerë të punëtorëve shqiptarë, duke ndikuar kështu në një vëllim të madh remitancash që ata dërgojnë në Shqipëri. Një vlerësim i saktë sasior i këtyre remitancave është i vështirë, për arsye se pjesa më e madhe e tyre kryhet jashtë kanaleve të sistemit bankar. Në fakt, ka shumë mundësi që të dhënat zyrtare të nënvlerësojnë ndjeshëm fluksin e remitancave. Korovilas (1999), duke u bazuar në numrin e emigrantëve shqiptarë që punojnë jashtë dhe në një mesatare të shumës që ata dërgojnë zakonisht në Shqipëri, konkludon se niveli i remitancave mund të arrijë në 850 milionë usd në vit - duke tejkaluar me 300 milionë usd vlerësimet zyrtare.
15. Llogaria kapitale është dominuar nga financime koncensionale dhe zëra që nuk krijojnë borxhe, të tilla si transfertat zyrtare, grante dhe hua koncensionale, të cilat së fundi kanë qenë mesatërisht 200 milionë usd në vit ose 5 për qind e PBB-së. Investimet e huja direkte, gjithashtu, kanë shënuar rritje - duke arritur në rreth 3 për qind të PBB-së në vitin 2000 - të ndihmuara nga privatizimi në shkallë të gjerë dhe investimet që ndjekin këtë proces, por

gjithashtu edhe nga investimet fillestare veçanërisht në sektorin e naftës. Ndërsa qëndrueshmëria e këtyre investimeve direkte të huaja mbetet për t'u verifikuar - sidomos duke u nisur nga fakti që një pjesë e madhe e tyre janë të lidhura me privatizimin - rritja e tyre në vitet e fundit përfaqëson një ndryshim të rëndësishëm nga vitet e mëparshme dhe mund të sinjalizojë fillimin e një periudhe me një qëndrueshmëri më të madhe të bilancit të pagesave dhe të rritjes ekonomike.

16. **Ndërsa ecuria makroekonomike e Shqipërisë ka qenë inkurajuese, qëndrueshmëria e saj është larg të qenurit e sigurtë dhe ajo ka patur deri tani një impakt të vogël në reduktimin e varfërisë.** Bilanci i pagesave dhe rritja ekonomike e Shqipërisë vazhdojnë të jenë shumë të varur nga remitancat dhe transfertat zyrtare, të cilat kanë një natyrë të luhatshme dhe janë të paqëndrueshme ndaj krizave ekonomike dhe politike. Gjithashtu, kriza e vazhdueshme energjitike i zvogëlon hapësirat për investimet e brendshme dhe të huaja dhe është rreziku më i madh për ruajtjen e normave të larta të rritjes. Forcimi i qëndrueshmërisë së arritjeve makroekonomike të Shqipërisë dhe reduktimi i varfërisë do të kërkojnë përmirësimin e klimës së biznesit, për të tërhequr një numër më të madh investimesh vendase dhe të huaja. Gjithashtu, rritja e të ardhurave buxhetore do të ulë varësinë nga financimet e huaja dhe do të rrisë shpenzimet në zonat e varfra.

ZHVILLIMET FISKALE

17. **Një nga elementet kryesore të përpjekjeve të qeverisë për konsolidimin fiskal - i cili u diskutua edhe më parë - ishte rritja e të ardhurave buxhetore.** Shqipëria ka shënuar rezultate të lavdërueshme në këtë drejtim, ku të ardhurat nga taksat dhe nga doganat janë rritur me rreth 5 pikë përqindjeje ndaj PBB-së që nga viti 1996 (tabelat 9 dhe 11). Këto rezultate impresionuese u arritën nga

reforma e TVSH në vitin 1997, ku norma e zbatuar u rrit nga 12.5 për qind në 20 për qind, dhe nga përmirësimet substanciale në eficiencën administrative të organeve doganore dhe tatimore. Korrupsioni dhe kontrabanda në zonat doganore ka rënë ndjeshëm, siç tregohet nga rritja e madhe e vëllimit të mallrave të deklaruar që i nënshtrohen akcizës, si naftës, cigareve, kafesë, alkolit dhe birrës (tabela 10). Një element i rëndësishëm në përmirësimin e të ardhurave nga taksat e importit ishte forcimi i aftësive hetuese dhe i auditit të brendshëm, si dhe implementimi i shpejtë i masave disiplinore ndaj zyrtarëve të doganave, të cilët kishin kryer shkelje të kodit doganor. Gjithashtu, edhe adoptimi i skemave moderne të vlerësimit në bazë të meritës për inspektorët doganorë, ka ndihmuar në krijimin e një balance më të drejtë midis kontrollit dhe motivimit.

Tabelë 9. Të ardhurat nga taksat e importit (TVSH, akciza dhe taksa doganore) 1996 – 2001.

	1996	1997	1998	1999	2000	2001
Të ardhurat nga taksat e importit (milionë lekë)	16,187	22,045	36,240	36,052	47,693	51,800
Të ardhurat nga taksat e importit (milionë usd)	154.9	148.0	240.6	261.8	331.9	357.2
Të ardhurat nga taksat e importit (përqindje ndaj PBB-së)	5.8	6.5	7.9	7.1	8.9	8.8

Burimi: Ministria e Financave.

Tabelë 10. Importet e mallrave subjekt i akcizës, 1996 - 2001 (volum në ton).

	1996	1997	1998	1999	2000	2001
Kafe	668	95	172	2,354	3,603	...
Cigare	942	116	579	2,115	2,267	...
Karburante	80,469	67,618	88,271	172,205	230,289	...
Birrë	12,0,82	4,754	10,685	26,392	32,686	...

Burimi: Ministria e Financave.

Tabelë 11. Të ardhurat e brendshme nga taksat, 1996 - 2001.

	1996	1997	1998	1999	2000	2001
Të ardhurat e brendshme nga taksat (milionë lekë)	14,427	10,733	20,765	28,164	34,786	41,500
Të ardhurat e brendshme nga taksat (milionë usd)	138.1	72.3	137.8	204.5	242.1	286.2
Të ardhurat e brendshme nga taksat (përqindje ndaj PBB)	5.1	3.2	4.5	5.6	6.5	7.1

Burimi: Ministria e Financave.

- 18. Të ardhurat e brendshme nga taksat dhe tatimet u rritën ndjeshëm si rezultat i rritjes së numrit të taksapaguesve të regjistruar dhe adoptimit të një legjislacioni tatimor modern, i cili e ka rritur aftësinë e organeve tatimore në luftën ndaj evazionit fiskal.** Gjithashtu, edhe veprimi i Njesisë së Tatimpaguesve të Mëdhenj është forcuar si rezultat i pajisjes me ambiente të reja dhe i përmirësimeve në strukturën organizative.
- 19. Një gjë që duhet vërejtur është fakti se pas reformës së TVSH, normat e taksave kanë mbetur të pandryshuara ose janë ulur.** Tarifat maksimale u ulën ndjeshëm që nga fillimi i vitit 1999 nga 30 për qind, në 15 për qind aktualisht, dhe së bashku me eliminimin e plotë të pengesave jotarifore rezultuan, në një përmirësim substancial të renditjes së Shqipërisë në shkallën e indeksit të tregtisë së përgjithshme të Fondit Monetar Ndërkombëtar, nga 6 në fillim të vitit 1998, në 1 aktualisht (shkalla është nga 1 në 10). Për më tepër, tatimi mbi fitimin u ul nga 30 për qind në 25 për qind, në vitin 2001.
- 20. Megjithëse rritja e të ardhurave ka qenë e ndjeshme, evazoni fiskal mbetet mjaft i përhapur, veçanërisht në fushën e të ardhurave personale, por edhe në atë të tatimit mbi fitimin dhe TVSH.** Raporti i të ardhurave nga tatimet ndaj PBB-së në Shqipëri, edhe duke marrë parasysh nivelin mjaft të ulët të PBB-së për frymë, është ende ndër më të ultit e vendeve të Europës Lindore me

norma tatimore të krahasueshme, duke treguar se potenciali për rritje të të ardhurave buxhetore është i madh.

21. **Një rritje substanciale e mëtejshme e të ardhurave do të jetë e nevojshme për të reduktuar deficitin e përgjithshëm buxhetor ende të lartë, dhe për të siguruar një qëndrueshmëri të borxhit dhe një qëndrueshmëri fiskale, për sa kohë që niveli i borxhit të Shqipërisë - dhe veçanërisht borxhi i brendshëm - mbetet relativisht i lartë.** Brenda pak viteve të ardhshme, të ardhurat e privatizimit priten të arrijnë në nivelin maksimal për t'u zhdukur më tej. Gjithashtu, edhe financimi koncensional nuk do të jetë i disponueshëm përgjithnjë. Në këtë kontekst, me qëllim për të mbajtur shkallën e borxhit publik në një kurbë rënëse, disiplina fiskale do të ketë një rëndësi vendimtare. Për më tepër, autoritetet shqiptare, megjithë nevojat mëdha për investime në infrastrukturë, duhet të jenë shumë selektive në tërheqjen e huave që nuk janë (ose nuk janë plotësisht) koncensionale.
22. **Përpjekjet për të rritur të ardhurat buxhetore janë shoqëruar nga hapa për të reduktuar përmasat e administratës publike, me synim rritjen e hapësirës për shpenzimet prioritare.** Zvogëlimi i administratës publike - i përmendur edhe më lart - u bë me qëllim për të përmirësuar shërbimet publike duke modifikuar strukturën e pagave dhe duke krijuar një shërbim civil më kompetitiv. Si rezultat i kësaj politike, raporti i shpenzimeve për paga ndaj shpenzimeve totale ra nga 26 për qind në vitin 1996, në më pak se 20 për qind në vitin 2001 - megjithëse, që nga viti 1997, pagat janë rritur mesatarisht me 40 për qind në terma realë ato nuk e kanë arritur ende nivelin e vitit 1996.
23. **Barra e pagimit të interesave mbetet e lartë, sidoqë ajo është në rënie.** Si rezultat i reduktimit të huamarrjes së brendshme dhe i uljes së normave të interesit të bonove të thesarit, pjesa e shpenzimeve për interesa ndaj shpenzimeve totale, pasi arriti një pik prej 25 për qind, në vitin 1998, për shkak të huamarrjes së lartë të brendshme në vitet 1996 - 1997, zbriti në 16 për qind, në vitin 2000, dhe pritet të bjerë më tej, në 11 për qind, në vitin 2001, duke u kthyer kështu në nivelin e vitit 1996.

24. **Zvogëlimi i pjesës së shpenzimeve për interesa dhe për paga, së bashku me forcimin e ndjeshëm të mbledhjes së të ardhurave, sollën në një rritje të alokimit të resurseve për shpenzime prioritare, si shfrytëzimi dhe mirëmbajtja, investimet në infrastrukturë, arsim dhe shëndetësi.** Për shembull, shpenzimet për investime të financuara nga buxheti u rritën nga 1.9 për qind e PBB-së në vitin 1997, në 3.4 për qind të PBB-së në vitin 2001, duke bërë që disa projekte rrugësh, objektesh shëndetësore dhe ujësjellësa të financohen direkt nga buxheti. Megjithatë, shpenzimet buxhetore në projektet e infrastrukturës duhet të rriten akoma më shumë për të ulur varësinë e Shqipërisë nga asistenca e huaj dhe për të konverguar me nevojat e saj të zhvillimit. Një tjetër prioritet kyç është rritja e alokimit të shpenzimeve të shfrytëzimit dhe të mirëmbajtjes, gjë që bëhet e domosdoshme për të siguruar qëndrueshmërinë e projekteve infrastrukturore të përfunduara tashmë.
25. **Qeveria ka ndërmarrë iniciativa të rëndësishme për të përmirësuar eficiencën e shpenzimeve në kontekstin e Kuadrit Afatmesëm të Shpenzimeve (*Medium-Term Expenditure Framework*, - MTEF sipas iniciaveve anglisht) dhe Strategjisë për Rritjen dhe Reduktimin e Varfërisë (GPRS sipas iniciaveve anglisht).** MTEF, i përgatitur për herë të parë në vitin 2000, ka si qëllim të ofrojë një fokus më strategjik të procesit të buxhetit. Ai krijon një mekanizëm transparent për të bërë shpërndarjen e burimeve duke u bazuar në prioritetet strategjike, të përcaktuara në mënyrë sistematike në GPRS. Si MTEF dhe GPRS janë iniciativa kyçe, që do të lejojnë një cilësi më të lartë në hartimin dhe në zbatimin e politikave dhe të vendimmarrjeve. Megjithatë, administrimi i shpenzimeve mbetet ende i mangët:
- aftësia e ministrive të linjës në zhvillimin dhe implementimin e programeve të politikave të plota mbetet e dobët. MTEF dhe GPRS kanë si synim të sigurojnë një lidhje strategjike në vendimet e shpenzimeve, por kufizimet e kapacitetit - veçanërisht brenda ministrive të linjës - kufizojnë efektivitetin e këtyre instrumenteve;
 - monitorimi dhe vlerësimi i programeve dhe shpenzimeve duhet të forcohet dukshëm. Aktualisht,

procesi i monitorimit kufizohet vetëm në indikatorët e kostove të faktorëve, ndërkohë që duhet të zhvillohet kontrolli sistematik i treguesve të prodhimit.

26. Ministria e Financave ka filluar të forcojë ndjeshëm kontrollin e shpenzimeve publike. Auditimet e fundit të bëra nga Bashkimi Europian dhe donatorët e huaj tregojnë, përgjithësisht, një vlerësim pozitiv të përgjegjshmërisë në kryerjen e shpenzimeve. Gjatë vitit 2000, u adoptua një klasifikim i ri ekonomik, shumë më i detajuar i shpenzimeve, duke përmirësuar transparencën fiskale. Megjithatë, mbetet ende shumë për të bërë:

- buxheti ende nuk hartohet sipas standardeve të GFS;
- mbulimi nga buxheti i shpenzimeve kapitale të financuara nga burime të huaja mbetet i kufizuar. Projektet e financuara nga grantet janë kryesisht jashtë buxhetit, si pasojë e hezitimit të disa donatorëve për t'i kanalizuar projektet nëpërmjet buxhetit. Saktësia dhe rëndësia kohore e informacionit në pjesë të tjera të projekteve të financuara nga huatë, mbetet e pakënaqshme për shkak të mungesës së raportimeve nga Njësia e Zbatimit të Programeve;
- mekanizma kontrolli më sistematikë - duke përfshirë forcimin e funksionit të auditorit të brendshëm - duhet të adoptohen për të siguruar që përdorimi i fondeve është ai më i miri. Kjo është veçanërisht e nevojshme në rrugën aktuale drejt decentralizimit.

TREGJET FINANCIARE DHE POLITIKA MONETARE

27. Sjellja dhe efektiviteti i politikës monetare janë kushtëzuar nga mungesa e tregjeve të zhvilluara financiare dhe nga kufizimet institucionale për motive kujdesi ndaj huadhënies. Megjithëse sektori bankar ka qenë në një zhvillim të vrullshëm që nga viti 1997 - ashtu siç dëshmohet nga ekspansioni i rrjetit të degëve dhe shkalla relativisht e lartë e depozitave ndaj PBB-së, - sistemi financiar, në tërësinë e vet, mbetet i pazhvilluar.

Aktiviteti i kreditimit të Bankës së Kursimeve është akoma i ndaluar për arsye kujdesi duke u nisur nga shkalla e lartë e borxheve të këqija në portofolin e tyre¹⁷. Nga ana tjetër, huadhënia nga bankat private nuk mund ta kompensojë plotësisht këtë, për arsye të madhësisë së vogël të tyre. Sidoqoftë, në thelb, kreditimi vuan nga kufizimet strukturore: një kuadër jo i qartë ligjor, mungesa e eksperiencës së huamarrësve në përfitimin dhe në shfrytëzimin e kredisë dhe rrjeti i kufizuar i degëve. Dominimi i Bankës së Kursimeve - e cila mban rreth 80 përqind të tregut për depozita dhe bono thesari, konkurrenca e ulët e sektorit financiar, dhe administrimi i dobët i likuiditetit nga bankat, kanë penguar zhvillimin e tregjeve sekondare dhe ndërbankare të bonove të thesarit. Gjithashtu, edhe përpjekjet për forcimin e Bursës së Tiranës kanë qenë të kufizuara dhe vetëm së fundi kanë marrë shtysën e duhur.

- 28. E ndodhur përballë një situatë të tillë, Banka e Shqipërisë ka ndjekur një politikë monetare konservatore, e cila synonte kontrollin e inflacionit duke i mbajtur normat e interesit në nivele pozitive të larta.** Banka e Shqipërisë ka synim ta mbajë inflacionin në nivelin 2 - 4 përqind, në kontekstin e një regjimi fleksibël të kursit të këmbimit. Fillimisht, instrumenti kryesor i politikës monetare të Bankës së Shqipërisë ishte kontrolli i nivelit minimal të normave të interesit të bankave me kapital shtetëror, por marrëveshjet e riblerjes dhe ato të anasjellta të riblerjes u bënë gradualisht mbizotëruese. Në shtator të vitit 2000, Banka e Shqipërisë eliminoi kontrollin e normave të interesit të depozitave duke kaluar tërësisht në instrumentet indirekte të politikës monetare.
29. Ndërsa kalimi në instrumentet indirekte të politikës monetare është një hap i rëndësishëm përpara, efektiviteti i politikës monetare mbetet i kufizuar si rezultat i mungesës së tregjeve financiare eficiente, që do të mundësonin transmetimin e vendimeve të politikës monetare në ekonominë reale.
- 30. Mbikëqyrja e sektorit financiar është përmirësuar ndjeshëm pas rrëzimit të skemave piramidale në vitin**

¹⁷ Ndalimi i huadhënies për Bankën Kombëtare Tregtare u hoq pas privatizimit të saj në tetor 2000, por Banka Kombëtare Tregtare ka filluar huadhënien vetëm së fundi dhe në mënyrë të kujdesshme.

1997; rregullat dhe rregulloret janë përgjithësisht në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe kontrollet bëhen në intervale të rregullta. Megjithëse sistemi bankar mund të konsiderohet, përgjithësisht, i shëndetshëm, diversifikimi i fundit i aktivitetit bankar dhe rritja e huadhënies e bëjnë të nevojshëm përmirësimin e teknikave të mbikëqyrjes dhe zhvillimin e aftësive moderne në administrimin e rrezikut nga bankat tregtare.

- 31. Ndonëse sistemi financiar shqiptar është i pazhvilluar, perspektivat e forcimit dhe të thellimit të mëtejshëm të tij janë relativisht të mira.** Privatizimi i Bankës Kombëtare Tregtare dhe sjellja më agresive e bankave të tjera private krijojnë kushte më të mira për forcimin e konkurrencës në sistemin bankar dhe një rol dominant më të ulët të Bankës së Kursimeve në të ardhmen. Gjithashtu, po ndërmerren hapa edhe në zgjerimin e tregut të bonove të thesarit, duke rritur pjesëmarrjen e individëve dhe duke zhvilluar tregun e aksioneve. Për më tepër, adoptimi i ligjit "Për sigurimin e transaksioneve" dhe hapja e regjistrit të pasurisë së tundshme në fillim të vitit 2001, janë hapa të rëndësishëm në përmirësimin e strukturës ligjore dhe institucionale të huadhënies.

REFORMAT STRUKTURE

32. Një objektiv kyç i axhendës së reformave strukturore të qeverisë ka qenë privatizimi i ndërmarrjeve strategjike dhe i atyre të vogla e të mesme, privatizim i cili ka ecur mirë, megjithëse në disa raste më ngadalë nga sa ishte parashikuar fillimisht. Procesi i privatizimit i ka rritur mundësitë e një rritjeje të qëndrueshme ekonomike.
33. Së fundi, janë përfunduar disa projekte të mëdha privatizimi. Këto përfshijnë, kompaninë e telefonisë së lëvizshme AMC, dhe dhënien e kontratave të rëndësishme koncensionare për minierat e kromit dhe të bakrit në vitin 2001. Shitja e licencës së dytë GSM u përfundua në vitin 2001 dhe tashmë është operative. Privatizimi ose likuidimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme u përfundua gjatë vitit 2001. Disa prej tyre, si Fabrika e Çimentos në Fushë-Krujë apo Uzina e Superfosfatit në Laç iu shitën investitorëve të huaj. Privatizimi i Bankës Kombëtare Tregtare, BKT, në tetor të vitit 2000 nga një konsorcium i përbërë nga një bankë private, IFC dhe BERZH krijoi parakushtet për

privatizimin e Bankës së Kursimeve, proces i cili pritet të përfundojë në fund të vitit 2002. Gjithashtu, interes i rëndësishëm është treguar edhe në sektorin e naftës nga kompanitë e huaja aktive në këtë sektor. Privatizimi i kompanisë së telekomunikimit me linjë fikse dhe elementet e mbetura nga firma e naftës Albpetrol pritet të përfundojnë në vitin 2002. Megjithëse këto zhvillime janë inkurajuese, vazhdimi i axhendës së reformave të Shqipërisë do të varet detyrimisht nga progresi në një numër fushash të reformave strukturore.

34. **Kriza e fundit energjitike** nxori në dritë faktin se progresi i mëtejshëm ekonomik do të jetë në rrezik, në qoftë se nuk kryhet një ndryshim rrënjësor i politikave të këtij sektori. Në dhjetor të vitit 2000, u adoptua një strategji dyvjeçare për sektorin energjitik, e cila përfshinte objektiva specifike për të pakësuar humbjet, për të rritur mbledhjen e pagesave të energjisë, modifikimin e strukturës së tarifave dhe promovimin e burimeve alternative të energjisë. Zbatimi i kësaj strategjie, deri më tani ka qenë i kënaqshëm, por megjithatë, vjelja e faturave mbetet nën dhe humbjet mbeten mbi nivelet e pranueshme. Një vëmendje e veçantë i duhet kushtuar dënimit efektiv të vjedhjes së energjisë duke përdorur kodin penal të amenduar, promovimit të burimeve alternative të energjisë duke përfshirë gazin, dhe zhvillimit e forcimit të kodit të ndërtimit, përmirësimit të mbledhjes së pagesave të energjisë nga ndërmarrjet e ujësjellësit, të cilat janë ndër debitorët kryesorë të KESH-it. Së fundi, krijimi i impianteve të reja të prodhimit të energjisë duhet të vlerësohet me kujdes dhe kryerja e punës së nevojshme të mirëmbajtjes në rrjetin elektrik nuk duhet të shtyhet.
35. **Sistemi gjyqësor** në segmente të mëdha të tij, nuk është funksional, duke rritur pasigurinë në detyrimin e respektimit të të drejtave të lindura nga marrëdhëniet kontraktuale. Pavarësia e organeve gjyqësore dhe të prokurorisë duhet të forcohet më tej, ndërsa punonjësit e korruptuar të tyre duhet të spastrohen dhe të dënohen. Proceset burokratike të përfitimit të lejeve dhe të licencave shpesh nuk janë transparente, ndërsa e drejta e pronësisë mbetet e pasigurt. Këto probleme kanë krijuar një ambient të vështirë për investitorët vendas dhe të huaj dhe duhen të trajtohen në mënyrë sistematike. Megjithëse investimet e huaja direkte kanë shënuar rritje të ndjeshme në vitet e

fundit, vlerësimi i investitorëve për ambientin është përgjithësisht negativ dhe shumë investitorë të interesuar fillimisht, nuk i realizojnë projektet e tyre.

36. Një problem tjetër strukturor i një rëndësie thelbësore është dhe fusha e **mbrojtjes ambientale**, e cila mund të ndikojë negativisht në perspektivën afatgjatë të zhvillimit ekonomik. Uji dhe ajri janë subjekt i ndotjeve të mëdha nga ndërmarrjet industriale dhe nga qytetarët privatë. Programi ambiental i Kombeve të Bashkuara kërkon zhvendosjen urgjente të popullsisë nga disa zona të Shqipërisë për shkak të rreziqeve ekstreme dhe imediate shëndetësore. Ndotja e detit nga ujrat e mbetur, ka dëmtuar seriozisht potencialin turistik të bregdetit shqiptar, ndërsa djegia e pakontrolluar e plehërave në zonat urbane, përbën një rrezik të madh për shëndetin publik. Pyjet shqiptare janë zvogëluar ndjeshëm si pasojë e çpyllëzimit dhe e erozionit. Megjithëse krijimi i Ministrisë së Ambientit dhe përgatitja e taksave të veçanta ambientale janë hapa pozitivë, adoptimi i një programi efektiv të mbrojtjes ambientale do të kërkojë bashkëpunimin e ngushtë të disa ministrive të linjës.

KONKLUZIONE

37. Shqipëria ka bërë një progres të dukshëm gjatë viteve të fundit, por probleme serioze mbeten në shumë fusha. Shumë nga këto probleme reduktohen në probleme të qeverisjes dhe të krijimit të kapaciteteve. Ka një nevojë thelbësore për të forcuar institucionet ekzistuese, në mënyrë që të vendoset shteti ligjor, i cili garanton zbatimin e ligjit në mënyrë të drejtë dhe të barabartë në të gjitha fushat. Progresi në qëndrueshmërinë fiskale do të varet, në një masë të madhe, nga rritja e të ardhurave, të cilat do të jenë rezultat i luftës ndaj korrupsionit dhe ndaj evazionit fiskal. Reforma e sektorit energjitik varet ndjeshëm nga progresi në luftën ndaj vjedhjes së energjisë dhe nga detyrimi i pagesës së faturave të energjisë si dhe implementimi i kodeve të ndërtimit, që përcaktojnë përdorimin e burimeve joelektrike për ngrohje. Përmirësimi i klimës së investimeve do të kërkojë edhe një besueshmëri më të madhe të sektorit gjyqësor, kredibiliteti i të cilit mbetet i dëmtuar nga korrupsioni.
38. Gjithashtu, duhet të ketë një theks të vazhdueshëm në reformën e administratës publike. Për të rritur më tej

tërheqjen e shërbimit publik, të dëmtuar nga shkurtime të punonjësve dhe nga motivimi i ulët, qeveria do të adoptojë një strukturë të re rrogash për nivelet e larta të zyrtarëve civilë, e cila parashikon rritje page edhe në masën 100 për qind për disa prej tyre, megjithëse niveli i përgjithshëm i pagave është rritur në përputhje me rritjen e PBB-së nominale. Reforma të ngjashme - duke përfshirë një diferencim më të madh të pagave në përputhje me karakteristikat e punës - janë planifikuar për sektorët e arsimit dhe të shëndetësisë, ku pagat janë ndjeshëm nën nivelin mesatar të administratës publike. Këto masa janë pjesë e një reforme më të gjerë të shërbimeve civile, që ka si synim depolitizimin e administratës së tij dhe përfshin, gjithashtu, dhe përgatitjen sistematike të vlerësimit të performancës, hartimin e përshkrimit të vendit të punës dhe ristrukturimin e ministrive. Zbatimi i vazhdueshëm dhe forcimi i procesit të MTEF do të rritë eficiencën e shpenzimeve publike dhe duhet t'i shërbejë edhe objektivit të qeverisë për reduktimin e varfërisë.

40. Megjithë vështirësitë, progresi i realizuar që nga viti 1997 tregon se në Shqipëri ndryshimet pozitive, me hapa të shpejtë, janë të mundshme.

41. REFERENCA

Hadëri S., H. Papapanagos, P. Sanfey dhe M. Talka. "Inflation and Stabization in Albania", *Discussion Paper No. 96/13, University of Kent, 1996.*

IMF, "Albania - Recent Economic Developmnents" *Washington D.C. Inernational Monetary Fund, February 20, 1997.*

Jarvis, Chris, "The Rise and Fall of the Pyramid Schemes in Albania". (*IMF working Paper 99/98, IMF, Washington, D.C, July 1999*).

Korovilas, James p., "The Albanian Economy in Transition; The Role of Remittances and Pyramid Investment Schemes", *Post-Communist Economies, Vol. 11, No.3, 1999*.